



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:150177

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06169582

Ac.nr.5024/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit G. B. nga fshati D. , Komuna e I., të cilin e përfaqëson Xh. B., avokat në P. , sipas autorizimit, kundër të paditurës B. K. S. - (BKS) sh.a., me seli në P., rr. të cilën e përfaqëson O. H. , sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësit dhe ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.129/19 i datës 21.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit G. B. nga fshati D., Komuna e I. dhe ankesa e të paditurës BKS, me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.129/19 i datës 21.05.2021, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë së aprovuar për kompensimin e dëmit jomaterial dhe material, në pikën II, të dispozitivit në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e aprovuara dhe atë për kompensimin e dëmit jomaterial për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në pikën III, të dispozitivit për kamatën dhe në pikën IV, të dispozitivit në pjesën e kërkesës për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e paditësit G. B. nga fshati D., Komuna e I., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.129/19 i datës 21.05.2021, në pikën II, të dispozitivit në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura BKS sh.a, me seli në P., që paditësit G. B. nga fshati D., Komuna e I., në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 14.02.2019, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj për 80 % të përgjegjësisë, t'i paguaj shumën prej 55€ dhe 55€ për ushqimin e përforcuar, gjithsej shumën

prej 110€ me kamatë ligjore nga data 21.05.2021, e deri në pagesën përfundimtare. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.129/19, të datës 21.05.2021, ka vendosur si në vijim:

APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit G. B. nga fsh. D., Komuna e I..

I. DETYROHET e paditura K. e S. “BKS” sh.a., me seli në P., që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për aksidentin e dt. 14.02.2019, nga baza e autopërgjegjësisë për 80% të përgjegjësisë, ti paguaj shumën prej 4.500 euro, të specifikuara si më poshtë:

Dëmi jomaterial:

- për dhimbjet e përjetuara fizike 2.300euro.
- për shkak të frikës së përjetuar 1.200 euro.
- për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....1.000 euro.

Dëmi material:

Për shpenzimet e mjekimit109 euro

II. REFUZHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit G. B., përtej shumës së gjykuar, në pikën I, në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për aksidentin e dt. 14.02.2019 për shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jomaterial:

- për dhimbjet e përjetuara fizike1.700 euro.
- për shkak të frikës së përjetuar1.800 euro.
- për shkak të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm jetësor.....1.000 euro,

Dëmi material:

Ushqim të përforcuar.....70 euro

Ndihma ngs personi tjetër.....105euro

III. Detyrohet e paditura K.e S. “BKS” me seli në P., që shumat e gjykuara, si në pikën I, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, t’i paguaj me kamatë ligjore sipas normës: 8% ,nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 23.04.2021 e deri në pagesën definitive e të gjitha këto t’i përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar,

IV. DETYROHET e paditura K. e S. “BKS” me seli në P.,që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej: 1.124 Euro e të gjitha këto t’i përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykohen shumat në lartësinë si në precizimin e kërkesëpadisë.

Kundër këtij aktgjykimi, në drejtim të pjesës aprovuese të kërkesëpadisë ankesë ka parashtruar e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se nuk është vërtetuar përgjegjësia në bazë të fajit, ndërsa shumat e gjykuara janë të larta dhe në kundërshtim me qëllimin që i shërben kompensimi i dëmit. Nga arsyet e parashtruara ka propozuar që ankesa të aprovohet, ndërsa në emër të kompensimit të dëmit paditësit t'i gjykohen shumat më të ulta konform Rregullores së BQK.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 28.03.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 13.04.2021, me të cilën ka kërkuar që të: Obligohet B. K. S. BKS, me seli në P., që ta kompensoj për të gjitha format e dëmit paditësin G. B. nga fshati D., Komuna I., sa i përket të gjitha formave të dëmeve shumë prej 9,284 €, të gjitha me kamatë prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, deri kur aktgjykimi të ekzekutohet; të obligohet B. K. S. "BKS", me seli në P. që shpenzimet e procedurës t'i paguaj si në kërkesën e precizuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.129/19, të datës 21.05.2021, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se nga provat e administruara është vërtetuar që me datë 14.02.2019 në rr. "R. K." në P. është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugor, në të cilën paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Aksidenti është shkaktuar me lëshimet e drejtuesit të automjetit A, (me drejtues të panjohur N.N), në të cilin aksident kontribut sekondar ka pasur edhe paditësi, i cili si këmbësor nuk ka treguar kujdes të shtuar në mënyrë që të mund ta evitonte dëmin.

Bazën juridike të kërkesëpadisë dhe kontributin e paditësit në shkaktimin e dëmit gjykata e vlerësoi nga provat materiale, repektivisht nga raporti i policisë dhe ekspertiza e komunikacionit. Ndërsa përgjegjësinë e të paditurës për kompenzimin e dëmit e vlerësoi nga shkresat penale, nga të cilat ka rezultuar se automjeti që nga i cili është shkaktuar aksidenti është i paidentifikuar, ndërsa sipas kallëximit penal ndaj NN procedura për shkaqe objektive nuk ka përfunduar. Prandaj nga këto rrethana gjykata erdhi në përfundim se përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi këtu të paditurën BKS.

Për lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. E. M. ortoped - traumatolog dhe Dr. M. H. psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 02.04.2021, kanë konstatuar se paditësi si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar lëndime trupore: ndrydhje të trupit, thyerje të bazës së kockës metatezave në bazën e saj në kockën e 4 të shputës së djathtë, të cilat kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhembje

fizike të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 3 orësh, dhembje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 orësh, të intensitetit të mesëm ka pasur 1 javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët vazhdon të ketë ende. Ndiqja e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 1 javë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 1 javë. Shërimi klimatik ka qenë ka i nevojshëm një herë në vit nga 10 ditë. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i shprehur në shkallë prej 3%. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Si pasojë e këtij aksidenti paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 3 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 8 javë dhe frikë sekondare me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 4 muaj.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136 paragraf 1, 140, 159 paragraf 1 dhe 2, 169, 174, 179 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata i është referuar nenit 317 dhe 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të paqëndrueshme janë pretendimet ankimore që aktgjykimi përfshihet me shkelje të dispozitave procedurale. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, ka rezultuar se në këtë rast përgjegjësia primare i takon të paditurës B. K. S. - (BKS) sh.a., me seli në P., rr. "L. e P." pn. Këtë përfundim gjykata e ka mbështetur në provat e administruara e në veçanti në vlerësimin e ekspertit të komunikacionit N.N. të datës 16.11.2020, nga ku rezulton se: NN nuk i ka kushtuar kujdes të veçantë përshtatjes së shpejtësisë. Pakujdesia për të reaguar me kohë në zvogëlimin e shpejtësisë sipas nevojës deri në minimum dhe mos mbajtjes së distancës anësore të sigurisë ndaj këmbësorit kanë qenë veprime në kundërshtim me rregullat e komunikacionit dhe se nuk ka mundur ta ndal mjetin apo ta shmang goditjen përderisa me pjesën e përparme e ka goditur këmbësorin duke i shkaktuar lëndime trupore. Ndërsa këmbësori i moshës 19 vjeçare e ka një pjesë të përgjegjësive, pasi që në pamundësi të shfrytëzimit të trotuarit, duke e shfrytëzuar rrugën qarkulluese për lëvizje, nuk i ka kushtuar kujdes të duhur rrjedhës së qarkullimit të automjetit NN.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore dhe ka gjetur së gjykata e shkallës së parë në pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht ka batuar në mënyrë të drejtë ligjin material sa i përket çështjes kryesore dhe lartësisë së kamatës të gjykuar.

Me vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 14.02.2019, rreth orës 12:50 minuta, në P., në rrugën "R. K." tek kolegji "...". Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti nuk është identifikuar. Shkaktari i cili ka

përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti është drejtuesi i automjetit “NN”, ndërsa këtu paditësi në cilësinë e këmbësorit ka përgjegjësi sekondare në shkaktimin e këtij aksidenti. Si pasojë e këtij aksidenti paditësi pëson lëndime të rënda trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga e paditura. Gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi në cilësi të këmbësorit ka pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se paditësi ka përjetuar dhembje fizike, frikë dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional. Në këtë rast e paditura edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht bazën juridike dhe lartësinë e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, baza juridike që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin, përveç të drejtës materiale të referuar si në aktgjykimin e ankimuar gjen mbështetje në dispozitat e nenit 20 të Ligjit. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ku përcaktohet që personi fizik i dëmtuar, të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrijë kërkesën për dëmshpërblim B.... Pra, e paditura sipas dispozitës ligjore në fjalë ka përgjegjësinë për kompensimin e dëmit, ndërkaq duke marrë për bazë edhe kontributin e paditësit në shkaktimin e dëmit, gjykata e shkallës së parë siç rezulton nga shkresat e lëndës, në caktimin e shumës së kompensimit ka pasur parasysh edhe kërkesën ligjore nga neni 176. 1 të LMD, ku përcaktohet se i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit, në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e cenuar, duke siguruar që kompensimi të shërbejë si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial, sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë, të konstatuar si në ekspertizë e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata, e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 3 %, dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana vlerësohen në kuptim të nenit 183 të LMD-së,

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material për shpenzimet e mjekimit, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë: fatura, kuponë fiskal dhe dëftesë pagesa si në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit vendosi si në

pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast shumat e kërkuara nga paditësi kanë qenë të larta në krahasim me lëndimet e konstatuara nga ekspertët mjekësor dhe se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do t'i shërbente qëllimit të kompensimit të dëmit.

Gjykata e Apelit e aprovoi pjesërisht ankesën e paditësit duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategorinë e dëmit material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar në raport me paditësin, pasi që vlerësoi se përkundër faktit se paditësi për këtë lloj të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, megjithkëtë nga praktika e gjertanishme e gjykatave të Kosovës, shpërblimi i dëmit i njihet të dëmtuarve edhe në mungesë të dëshmisë konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre. Prandaj, marrë parasysh se sipas ekspertizës mjekësore është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej shtatë ditësh dhe po aq ditë edhe për ndihmën dhe përkujdesin e personit të tretë, për këtë arsye kolegji i kësaj gjykate me vlerësimin e përgjegjësive së ndarë të paditësit dhe me referim në shumat që pranohet sipas praktikës gjyqësore si adekuate për këtë kategori të dëmit, vendosi që ankesën ta pranoj si të bazuar, ndërsa aktgjykimin në pjesën përkatëse, në kuptim të nenit 195.1 pika e) të LPK ta ndryshoj, duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5024/2021, me datë 30.08.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli